

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar 16 / 09 / 2020			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	462/01	38729	



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GLOGOCIT • OPSTINA GLOGOVAC • MUNICIPALITY OF GLOGOC



## KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË GLOGOCIT

Duke u bazuar në nenet 2, 3 paragrafi 1.4, nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 14, 17, 19 të Ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 19 paragrafi 1, nenet 13, 15, 20, 21 në Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, zbatimit të Vendimit 12-Nr.464-35992 dt. 31.08.2020 për miratimin paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik. Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Glogocit 12-Nr.400-23049 të datës 02.05.2019, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.09.2020, vendos për shpallje:

### NJOFTIM PUBLIK

**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale**

**Konkurimi publik për dhënien e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:**

- Parcela Kadastrale nr.P-70315016-01016-1, në sipërfaqe të përgjithshme 17733.0 m<sup>2</sup>, që gjendet në vendin e quajtur "Balta-Balta", Zona Kadastrale Glogoc
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-00202-1, në sipërfaqe të përgjithshme 3710.0 m<sup>2</sup>, që gjendet në vendin e quajtur: "Fshat-Fshat", Zona Kadastrale Komoran
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-01980-0, në sipërfaqe të përgjithshme 2003.0 m<sup>2</sup>, që gjendet në vendin e quajtur: "Fush Gjer", Zona Kadastrale Komoran
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe te përgjithshme 12111.0 m<sup>2</sup>, që gjendet në vendin e quajtur "Fush- Gjer", Zona Kadastrale Komoran
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-01981-0, në sipërfaqe të përgjithshme 3263.0 m<sup>2</sup>,

që gjendet në vendin e quajtur "Fush-Gjer", Zona Kadastrale Komoran

- Parcela Kadastrale nr.P-70310058-02652-2, në sipërfaqe të përgjithshme 3746.0 m<sup>2</sup>, që gjendet në vendin e quajtur "Ara te Zabeli", Zona Kadastrale Arllat
- Parcela Kadastrale nr.P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme 6863.0 m<sup>2</sup>, që gjendet në vendin e quajtur "Mahalla Binakve", Zona Kadastrale Gllobar.

### **Afati i dhënies në shfrytëzim**

- Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është afatgjatë deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

### **Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës**

- Parcelat të theksuara më lartë janë të destinuara për biznes-zona industriale me Plan Zhvillimor Komunal të Glllogocit.

### **Kriteret për vlerësimin e ofertave**

- Oferta ekonomike më e favorshme;
- Vlera e investimit;
- Numri i të punësuarve nga investimi;
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën;
- Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;

### **Kriteret të tjera të cilat përcaktohen me konkurs**

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe veprimtaria e përshtatshme;
- Për personat fizik certifikatën e nënshtetësisë;
- Projekti Ideor i Investimit;
- Për personat juridik pasqyrë financiare të audituara dhe qarkullimin bankar në pesë (5) vitet e fundit;
- Garanci bankare prej rreth 30 % të vlerës së investimit të projektit;
- Afati i realizimit të projektit të investimit është 18 muaj.

### **Pjesëmarrësit në këtë proces kanë të drejtë:**

- Të Informohen lidhur me procedurat e shprehjes së interesit,
- Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim,
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës,
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

**Periudha e vlefshmërisë së njoftimit publik do të jetë 15 ditë kalendarike, përkatësisht nga 16.09.2020- 30.09.2020**

**Ofertat** me dokumentacionin e plotësuar, aplikacionet tërhiqen, dhe duhet të dorëzohen në Komunën e Glllogocit, sporteli nr.10, 11, 12 në katin e parë, 1 origjinal dhe 2 kopje, në pliko të mbyllura, adresa "Fehmi Lladrovci", 13000, Glllogoc.

**Vendi, koha ku do të mbahet konkurimi publik:**

- Në sallën e Kuvendit Komunal, me datë 02.10.2020, në fillim në ora 09:00, do të bëhet hapja e ofertave dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në konkurs publik.

Të interesuarit mund të informohen çdo ditë pune përmes Ueb faqës së Komunës, <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>, Tel: 03820040812, E-mail-it zyrtar komuna.drenas@rks-gov.net.

Glllogoc, 16.09.2020



**Kryesuesi i Komisionit**  
Plutura Avdiu